

Njoftim për përqendrim me të cilin INFINUM shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për veprimtari dhe shërbime kompjuterike, Kroaci, do të fitojë kontroll të pavarur në mënyrë indirekte mbi AMR Cybersecurity Ltd, Mbretëria e Bashkuar

(Lënda nr. 08-149 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.10.2025 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin INFINUM sh.p.k. për veprimtari dhe shërbime kompjuterike, me seli në Mala Shvarça 23, Karlovac, Kroaci, përmes shoqërisë së vet të varur indirekte INFINUM CYBERSECURITY BIDCO LIMITED, me seli të regjistruar në Njësia 2, rruga Weller 14, Londër, SE1 1QU, Angli, *synon fitojë kontroll të pavarur në mënyrë indirekte mbi AMR Cybersecurity Ltd me adresë të regjistruar në 3000A Parkway, Whiteley, Hampshire, PO15 7FX, Mbretëria e Bashkuar.*

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste

Veprimtaria kryesore e regjistruar e INFINUM sh.p.k. është programimi kompjuterik.

Veprimtaria kryesore afariste e INFINUM CYBERSECURITY BIDCO LIMITED janë aktivitetet këshillimore në teknologjinë e informacionit.

Në Maqedoninë e Veriut, INFINUM sh.p.k. ka një shoqëri të varur të regjistruar – Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime INFINUM SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Maksim Gorki nr.13, 1000 Shkup dhe NUAS 6683150, me aktivitetin kryesor të regjistruar 62.09 – shërbime të tjera që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe kompjuterët.

Veprimtaria kryesore e AMR Cybersecurity Ltd janë shërbime të specializuara të sigurisë kibernetike.

Për qëllime të vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant të definohet si tregu për softuer infrastrukturor.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.10.2025

Shkup